

VENDIM
Nr. 702, datë 4.11.2022

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 KV, VALIAS”**

(Ndryshuar me VKM nr. 79, datë 5.2.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV, Valias”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 7 029 267 *(shtatë milionë e njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh*.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 029 267 *(shtatë milionë e njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh*, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale¹, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 8. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për pasuritë e shpronësuara.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, dhe Drejtoria e Miradministrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

¹ VKM nr. 79, datë 5.2.2025, botuar në F.Z nr. 26, datë 10.2.2025 në Kreun II shprehet: “II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.”

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
 “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV, VALIAS”
(Ndryshuar me VKM nr. 79, datë 5.2.2025)

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME	
	EMËR	ATËSIA	MBIEMËR	BASHKIA	NR. KADASTRAL	NR. I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE E PRONËS (m²)	VOL	FAQE	SIPËRFAQJA E SHPRONËSIMIT (m2)	ÇMIMI SIPAS STANDARDIT NDËRKOMBËTAR LACP (lekë/m²)	VLERA TOTALE E KOMPENSIMIT SIPAS STANDARDIT NDËRKOMBËTAR LACP (lekë/m²)	VLERA TOTALE (lekë)		
1	Devie dhe Kristina		Bushi	Tirane	2066	80/19	Are	4200	23	38	1879	1822	3,423,538.00	3,423,538.00		
2	Ramazan dhe Sajmir	Sami	Bushi	Tirane	2066	80/37	Are	1700	23	36	395	1822	719,690.00	719,690.00		
4	Vjollca	Sami	Bushi	Tirane	2066	80/39	Are	2600	1	222	1584	1822	2,886,048.00	2,886,048.00		
VLERA TOTALE											3858		7,029,276.00	7,029,276.00		